



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

Numri i lëndës: 2020:030158
Datë: 16.12.2024
Numri i dokumentit: 06606735

K.Dh.Sh.II.nr.575/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS- Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dren Rogova, kryetar, Faton Bajrami dhe Ramush Bardiqi, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Global Trade AF” me seli në Fushë Kosovë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK) në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti Fiskal, KF.nr.577/23 të datës 22.01.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 16.12.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti Fiskal, KF.nr.577/23 të datës 22.01.2024, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti Fiskal, KF.nr.577/23 të datës 22.01.2024, është vendosur si në vijim: Aprovohet kërkesëpadia e paditësit “Global Trade AF” sh.p.k, me seli në Fushë Kosovë, si e bazuar, II. Anulohet aktvendimi me nr.06.2/508/2016 të datës 22.01.2020 i Doganës së Kosovës me seli në Prishtinë, III. Obligohet e paditura Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit “Global Trade AF” sh.p.k, me seli në Fushë Kosovë, t’ia kthejë shumën e paguar në emër të kundërvajtjes së pretenduar doganore në vlerë prej 500.00 € (pesëqind euro), me kamatë ligjore prej 8 %, nga data 01.06.2016 e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë e paditura, për shkak të: zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, me propozimin që të aprovohet ankesa në tërësi si e bazuar në ligj, të priset aktgjykimi KF.nr.577/2023 i datës 22.01.2024 si i pa bazuar në ligj, të refuzohet padia dhe kërkesëpadia e paditësit në tërësi si e pabazuar në ligj dhe të mbetet në fuqi vendimi i kontestuar ose t’ia kthejë gjykatës në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore në ankesë dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA-së, nenit 81.H të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me Aktvendimin e kundërshtuar nr.06.2/508/2016 të datës 22.01.2020, është refuzuar si e pabazuar kërkesa e subjektit në procedurë “Global Trade AF” ShPK – Fushë Kosovë, për rishqyrtimin e aktvendimit nr.08.1.2-2016-217/2 të datës 01.06.2016 të lëshuar nga Drejtoria Rajonale Prishtinë – Njësi i PAKD-së.

Paditësi i pakënaqur me vendimin e të paditurës, ka ushtruar padi për konflikt administrativ, me pretendim se i njëjti është i padrejtë dhe i paligjshëm. Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit, si dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e aprovon si të bazuar, duke anuluar t vendimin e lartcekur të paditurës, si dhe duke obliguar të paditurën Dogana e Kosovës në Prishtinë, që paditësit “Global Trade AF” ShPK, me seli në Fushë Kosovë, t’ia kthejë shumën e paguar në emër të kundërvajtjes së pretenduar doganore në vlerë prej 500.00 € (pesëqind euro), me kamatë ligjore prej 8 %, nga data 01.06.2016 e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh nën kërcënim të përbarimit të detyrueshëm. Në arsyetimin e aktgjykimit kontestues është theksuar se Gjykata vlerëson se e paditura pa bazë ligjore dhe prova materiale të besueshme subjektit në procedurë i ka shqiptuar gjobën administrative në 5 (6) vlerë prek 500.00 €, ngase paditësi në këtë procedurë të kontestit tregtar-administrativ i ka paraqitur gjykatës provën si faturën me nr. FAEX/00042/2016 të datës 27.04/2016, CMR nr.0001490, EUR1 nr.0176941, 0662743 dhe deklaratën EXZ, me të cilat dokumente vërtetohet fakti se subjekti në procedurë, këtu paditësi ka deklaruar saktë origjinën e mallit lëndor kontestues ku në emërtimet nga 01 deri në emërtimin 12 e ka deklaruar si mall me origjinë nga Kina, pra në harmoni me dokumentacionin përcjellës të mallit. Gjykata ka vlerësuar se në rastin konkret edhe pse malli lëndor kontestues ka pasur barkodin e Republikës së Polonisë, paditësi nuk ka qenë përgjegjës për paketimin e mallit i cili ishte importuar nga eksportuesi. Andaj, gjykata nga shkresat e lëndës vlerëson se me asnjë provë nuk është provuar konstatimi i të paditurës i dhënë në vendimin e kontestuar, sipas të cilit paditësi nuk i ka ofruar dokumentet e nevojshme për zbatimin e procedurave doganore, ngase nga provat e lartcekura në mënyrë të qartë vërtetohet se malli i kontestuar është nga Republika e Kinës, e jo nga Republika e Polonisë.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë

duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore, si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore të paditurës, se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, këto pretendime ankimore nuk qëndrojnë, ngase aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës administrative, e as me shkelje të tjera të cilat do të ndikonin në drejtëshmërinë dhe ligjshmërinë e aktgjykimit të goditur. Meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së, dhe LPA-së.

Ndërsa, sa i përket pretendimeve ankimore të paditurës, se gjykata nuk ka administruar fare dokumentet e të paditurës, me të cilën e paditura nga sektor kompetent (Sektori i Origjinës) ka kërkuar sqarim rreth EUR 1 nr.0662743 që të konstatohet se malli lëndor çfarë origjine ka. Nga përgjigja e pranuar me datë 17.07.2016 theksohet se certifikata EUR 1 nr.0662743 nuk është certifikatë e cila lëshohet nga Dogana polake, dhe se certifikata në fjalë nuk i përmbush kriteret e parapara në aneksin II a, të protokollit të origjinës në Konventën PEM. Kolegji i kësaj gjykate nuk e ka aprovuar këtë pretendim, pasi përmes përgjigjes me email të pranuar më 17.07.2016, gjykata nuk mund të arrijë në përfundimin se certifikata EUR 1, e lëshuar nga shteti eksportues Polonia, është e pavlefshme. Përgjigja me email e datës 17.07.2016 nuk është mbështetur në ndonjë informacion të drejtpërdrejtë nga shteti eksportues (Polonia) që mund të vërtetonte se kjo certifikatë nuk është lëshuar nga ky shtet. Prandaj këtë pretendim të të paditurës kolegji i kësaj gjykate e konsideron si të të pa argumentuara dhe të pa qëndrueshëm në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, sepse e paditura me asnjë provë nuk i vërteton pretendimet e saj, ndërsa provat e prezantuara nuk janë me ndikim për vendosje ndryshe të kësaj çështje administrative juridike. Gjukata e shkallës së parë, me të drejtë ka konstatuar se dokumenti kyç që dëshmon origjinën e mallit e që është Deklarata e Origjinës apo siç ndryshe në tregtinë ndërkombëtare të mallrave njihet edhe si EUR 1, është paraqitur nga këtu paditësi si në procedurë tek e paditura ashtu edhe në këtë proces gjyqësor, provë: EUR1 nr.0176941, 0662743, e nga i cili dokument lehtësisht konstatohet se malli i importuar nga këtu paditësi është me origjinë të Kinës dhe jo të Polonisë siç ka pretenduar e paditura,

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditurës, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se te njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe

kjo gjykatë, andaj, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të kërkesëpadsisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 195 par. 1 pika (d) e LPK-së, të zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA -së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE PRISHTINË
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.Dh.Sh.II.nr.575/24, me datë 16.12.2024

Kryetari i kolegjit, gjyqtari
Dren Rogova